



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) - NR. 03/2024 PËR  
BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE DHE MEKANIZMAVE  
INSTITUCIONAL ME ORGANIZATAT JO QEVERITARE PËR  
REALIZIMIN E POLITIKAVE PËR TË DREJTAT DHE OFRIMIN E  
SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (QRK) – Nr.03/2024 për Bashkëpunimin e Strukturave dhe Mekanizmave Institucional me Organizatat Jo Qeveritare për Realizimin e Politikave për të Drejtat dhe Ofrimin e Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës, është miratuar në mbledhjen e 203 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr.08/203, të datës 08.05.2024.

## **Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në pajtim me nenin 8 (paragrafi 4, nën paragrafi 4.5) të Ligjit Nr. 08/117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19 paragrafi 6 (nënparagrafi 6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15, 12.09.2011),

Miraton:

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV(QRK) - NR.03/2024 PËR BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE DHE MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL ME ORGANIZATAT JO QEVERTARE PËR REALIZIMIN E POLITIKAVE PËR TË DREJTAT DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i bashkëpunimit të strukturave dhe mekanizmave institucional me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për strukturat dhe mekanizmat institucional në nivel qendror dhe lokal për të drejtat e fëmijës, si dhe organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me kuptimin e dhënë në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

#### **Neni 4**

##### **Parimet udhëheqëse**

1. Bashkëpunimi i strukturave dhe mekanizmave institucional në nivel qendror dhe lokal me organizatat joqeveritare udhëhiqet nga parimet e proklamuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe nga Ligji përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës.

2. Strukturat dhe mekanizmat institucional në nivel qendror dhe lokal dhe organizatat joqeveritare gjatë bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve të tyre duhen të kenë parasysh dhe të zbatojnë me prioritet parimet e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

## **KAPITULLI II**

### **REALIZIMI I POLITIKAVE PËR TË DREJTAT E FËMIJËS**

#### **Neni 5**

##### **Realizimi i politikave për të drejtat e fëmijës**

Politikat për të drejtat e fëmijës si dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre realizohen përmes një procesi gjithëpërfshirës të strukturave dhe mekanizmave institucional në nivel qendror dhe lokal për të drejtat e fëmijës, organizatave joqeveritare, komunitetit, prindërve dhe fëmijës.

#### **Neni 6**

##### **Planifikimi i politikave për realizimin e të drejtave të fëmijës**

1. Strukturat dhe mekanizmat institucional dhe organizatat joqeveritare, komuniteti, prindërit dhe fëmijët bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet për të planifikuar politika për realizimin e të drejtave të fëmijës.

2. Bashkëpunimi i strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal dhe organizatave joqeveritare bëhet përmes bashkërendimit të veprimeve dhe aktiviteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave për realizimin e të drejtave të fëmijës.

#### **Neni 7**

##### **Programi për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës**

1. Programi për realizimin e të drejtave të fëmijës përfshinë, por pa u kufizuar veprimet për:

1.1. parandalimin e rrezikut për jetën dhe mirëqenien e fëmijës;

1.2. mbrojtjen sociale dhe shëndetësore;

1.3. edukimin dhe arsimimin.

2. Strukturat dhe mekanizmat institucional në bashkëpunim edhe me organizatat joqeveritare sigurojnë zbatimin e politikave dhe programeve në realizimin e të drejtave të fëmijës.

### **Neni 8**

#### **Pjesëmarrja e fëmijës në hartimin e politikave për realizimin e të drejtave të fëmijës**

1. Respektimi i të drejtave të fëmijës është detyrim kryesor për strukturat dhe mekanizmat institucional dhe organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.

2. Në procesin e hartimit të politikave për realizimin e të drejtave të fëmijës marrin pjesë edhe fëmijët apo përfaqësuesit e tyre ligjor.

3. Pjesëmarrja e fëmijës në procesin e hartimit të politikave është vullnetare. Me rastin e pjesëmarrjes së fëmijës në këtë proces ofrohet siguria e nevojshme dhe respektohet privatësia e fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI III**

### **OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS**

### **Neni 9**

#### **Shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës**

1. Strukturat dhe mekanizmat institucional dhe organizatat jo qeveritare, bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës.

2. Shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës përfshijnë, por pa u kufizuar në:

1.1.shërbime shëndetësore;

1.2.mbrojtje dhe mirëqenie sociale;

1.3.edukim dhe arsimim;

1.4.drejtësi dhe siguri.

## **Neni 10**

### **Fëmijët përfitues të shërbimeve të nevojshme për mbrojtje**

Fëmijët në nevojë për mbrojtje janë përfitues të shërbimeve pa dallim dhe sipas parimit të gjithëpërfshirjes, integritimit dhe interesit më të mirë për fëmijën

## **KAPITULLI IV**

### **BASHKËPUNIMI**

#### **Neni 11**

##### **Qëllimi i bashkëpunimit**

Bashkëpunimi në mes të strukturave dhe mekanizmave institucional dhe organizatave joqeveritare synon të fuqizojë politikën për realizimin e të drejtave të fëmijës si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për fëmijën përmes mobilizimit dhe avokimit me akterët relevant, sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes të nevojshme për fëmijët si dhe avancimin e programeve për mbrojtjen e fëmijës.

#### **Neni 12**

##### **Format e bashkëpunimit**

1. Strukturat dhe mekanizmat institucional dhe organizatat jo qeveritare bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve dhe aktiviteteve për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës mund të realizojnë përmes formave të ndryshme.
2. Në varësi të natyrës së bashkëpunimit, palët përcaktohen për formën e bashkëpunimit në pajtim me ligjin.
3. Bashkëpunimi midis subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni bazohet në qëllimin dhe objektivat e përbashkëta për realizimin e politikave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e palëve për përmbushjen e objektivave.
4. Për realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, bashkëpunimi mund të krijohet për:
  - 4.1. shërbime sociale dhe shëndetësore;
  - 4.2. edukim dhe arsimim;
  - 4.3. drejtësi për fëmijë;
  - 4.4. shërbime multidisiplinare;
  - 4.5. aktivitete sportive dhe rekreative, dhe
  - 4.6. zhvillim profesional.

### **Neni 13**

#### **Roli i strukturave dhe mekanizmave institucional**

1. Për realizimin e politikave për të drejtat dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, strukturat dhe mekanizmat institucional të nivelit qendror dhe lokal:

1.1. identifikojnë dhe vleresojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës;

1.2. vendosin prioritetet për planifikimin dhe hartimin e politikave për shërbimet për mbrojtjen e fëmijës;

1.3. zbatojnë politika dhe programe për mbështetjen e fëmijës dhe atyre që kujdesen për fëmijën, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së fëmijës;

1.4. inkurajojnë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare pa cënuar pavarësinë e tyre përmes një procesi transparent dhe të bazuar në kriteret konkurruese.

### **Neni 14**

#### **Roli i Organizatave Jo qeveritare**

1. Roli i organizatave jo qeveritare për realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, përfshinë:

1.1. përfaqësimin e interesave të përbashkëta për fëmijët në strukturat vendimarrëse;

1.2. përfaqësimin e pikëpamjeve të fëmijës dhe promovimin e të drejtave të fëmijës;

1.3. ngritjen e vetëdijës dhe avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;

1.4. bashkëpunimin me strukturat dhe mekanizmat institucional në nivel qendror dhe lokal për identifikimin, vlerësimin e nevojave dhe realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

1.5. organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Neni 15**

#### **Dokumenti i politikës për mbrojtjen e fëmijës dhe kodi i mirësjelljes së Organizatave Jo Qeveritare**

Organizatat Joqeveritare që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës miratojnë dokumentin e politikës për mbrojtjen e fëmijës dhe kodin e mirësjelljes në të cilat përcaktohen, masat dhe hapat që duhet të ndërmerren për parandalimin, raportimin, reagimin, mbrojtjen e fëmijës dhe vetëdijësimin, si dhe përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 16**  
**Mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit**

1. Strukturat dhe mekanizmat institucional mbikëqyrin dhe auditojnë zbatimin e marrëveshjeve për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, si dhe inspektojnë ofrimin e shërbimeve të përcaktuara me marrëveshje.

2. Organizata jo qeveritare, e cila nuk i ka përmbushur detyrimet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit nuk mund të lidhë marrëveshje të tjera bashkëpunimi me strukturat dhe mekanizmat institucional të nivelit qendror dhe lokal.

**Neni 17**  
**Raportimi i organizatave joqeveritare**

Organizatave jo qeveritare raportojnë në baza të rregullta për zbatimin e veprimeve konkrete në realizimin e objektivave të përcaktuara në marrëveshje me strukturat dhe mekanizmat institucional në nivel qendror dhe lokal.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin Kurti**

---

**Kryeministër i Republikës së Kosovës**

**10 maj 2024**